

Konsultimi publik në Shqipëri 2017-2018



Më 1 Prill 2019, Res Publica prezantoi raportin për zbatimin e ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” gjatë viteve 2017-2018. Raporti është pjesë e një projekti të mbështetur nga National Endowment for Democracy, i cili konsiston në monitorimin dhe vlerësimin e proceseve të konsultimit publik, përfshirë edhe një vlerësim të punës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit, si organ kujdestar i këtij ligji.

Në qendër të prezantimit u vuri pyetja: A është konsultimi publik në Shqipëri një ushtrim i çiltër i demokracisë pjesëmarrëse apo thjesht një fasadë? Duke bërë krahasime me konceptimin e këtij procesi në vende të ndryshme të Evropës, raporti paraqet shifra për të kuptuar se deri në cilën shkallë pjesëmarrja e publikut në proceset vendimarrëse është e mirëpranuar nga qeveria. Në thelb vihet re se konsultimi publik në dy vitet e fundit nuk paraqet interes për qeverinë, por edhe për vetë publikun. Një numër i madh draftesh nuk konsultohen fare, ndërsa për një pjesë tjetër konsultimeve janë vetëm fasadë. Në një numër të vogël rastesh konsultimi ka qenë i vlefshëm për të dy palët, por numri i organizatave që zakonisht angazhohen është i vogël, ndërsa publiku i gjere nuk ka treguar interes. Regjistri elektronik i krijuar për të lehtësuar komunikimin e publikut me qeverinë nuk është përdorur, jo vetëm për shkak të apatise qytetare, por edhe për shkak të ideimit të gabuar të vetë regjistrimit. Një numër

rekomandimesh jane listuar ne fund te raportit, me qellim adresimin e shqetesimeve te ngritura. Per t'u njohur me studimin e plote, klikoni ketu per ta shkarkuar.